



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:145645

Datë: 03.03.2021

Numri i dokumentit: 01562311

**P.nr.758/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM**, gjyqtari Musë Povataj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sytkije Boja, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. K. nga fsh. ....Komuna ....., për shkak të veprës penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, sipas nenit 406 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për krime të Përgjithshme PP/II.nr.1798/20 të datës 28.10.2020, duke vendosur në lidhje me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, konform nenit 495 par 1 të KPP-së, jashtë seance me datë 08.02.2021 merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.nr.1798/20 të datës 28.10.2020, andaj gjykata jep këtë:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

**I akuzuari L. K.**, i lindur me datë ..... ne fsh. .... Komuna ....., ku edhe banon, nga babai S., nena S., ka te kryer shkollën e mesme, me profesion infermier, i identifikuar në baze te letërnjoftimit me nr....., shqiptari, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me datë 21.03.2019, rreth orës 09:45 në fsh. .... Komuna ....., në oborrin e shtëpisë së tije, hyn në objektin e siguruar me shenjë të ngjitur nga zyrtari i autorizuar për qëllim të sigurimit të objektit dhe at ne themelore e garazhes së siguruar për mes shiritave të vendosur nga inspektorët Komunalë të ndërtimit, në atë mënyrë që pasi i pandehurit katër javë me parë fillon ndërtimin pa leje të një garazhe me objekte përcjellëse në oborrin e tij, të njëjtit i ndërpriten punimet nga inspektorati Komunal dhe vendosen shiritat, ndërsa ditën kritike i pandehuri angazhon punë-kryesin me ekskavator që vazhdoj punimet e ndërprera duke anashkaluar shiritat dhe kaluar përtej tyre,

Me çka ka kryer veprë penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, sipas nenit 406 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7, 40, 43 par.1 nënpar 1.3, 406 të KPRK-së dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të pandehurit i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBË**

**Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind ) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ndaj të pandehurit L. K. nga fsh. .... Komuna ..... , ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1798/20 të datës 28.10.2020 për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, sipas nenit 406 të KPRK-së.

Konform nenit 493 të KPP të Kosovës, Prokuroria Themelore në Pejë, pas ngritjes së aktakuzës ka kërkuar që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të lëshoi urdhër ndëshkimorë me të cilin të pandehurit t'ia shqiptoi dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të çështjes konform nenit 495 të KP të Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPP të Kosovës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme për dhënien e urdhrin ndëshkimorë dhe shqiptoi ndaj të pandehuri dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata pasi i ka vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i policit hetues Kastriot Kasapi i datë 21.03.2020, Deklarata e të akuzuarit e dhënë ne

polici me datë 21.03.2020, Formulari për kërkesë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i datës 28.02.2020, Fotografit nga vendi i ngjarjes, ka gjetur se këto prova janë bindëse, të besuara dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese gjeti se më parë, nga shkresat e lëndës nuk shihet se i pandehuri i lartë cekur ka qenë e dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, Rrethanë renduese për të pandehurin nuk ka pasur.

Andaj, gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë i bindur se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, se me këtë dënim ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit të cilën e parasheh dispozita e nenit 41 të KP të Kosovës.

Vendimi lidhur me paushallin gjyqësorë u murr konform nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP të Kosovës.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 dhe 495 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEMPENAL**  
**P.nr.758/20, të datës 08.02.2021**

**G j q t a r i**

**Musë Povataj**

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh në këtë gjykatë, e përmes zyrës së pranimit të kësaj gjykate.